



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.69 datë 25.09.2024

PËR
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
TERRITORIT NR. 26, DATË 01.08.2023 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT
PËR OBJEKTIN: “PARISI I RI”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË, ME
SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË “SARA-EL” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 113, 116 të Kodit të Procedurave Administrative; Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; dhe Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 26, datë 01.08.2023 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Parisi i Ri”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Sara-El” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 11/11 / 2024